



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT
NACIONAL PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL
2030

Prishtinë, 2026

Përmbajtja

I.	HYRJE	4
II.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
III.	ZBATIMI I MASAVE TË PROGRAMIT NACIONAL PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2030	7
	OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1 – EKONOMI LOKALE KONKURRUESE	7
	Objektiva specifike 1.1 - Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal	7
	Objektiva specifike 1.2 - Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal	8
	Objektiva specifike 1.3 - Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion	11
	OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2 – PUNËSIM GJITHËPËRFSHIRËS;	12
	Objektiva specifike 2.1 - Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës	12
	Objektiva specifike 2.2 - Rritja e punësimit të dinjitetshëm për gra, të rinj dhe kategori të cenueshme	13
	OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3 – INFRASTRUKTURË LOKALE E PËRMIRËSUAR	14
	Objektiva specifike 3.1 - Përmirësimi infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve	14
	Objektiva specifike 3.2 - Sigurimi i qasjes në infrastrukturë përcjellëse	15
	Objektiva specifike 3.3 - Menaxhimi i integruar i mbeturinave	17
	Objektiva specifike 3.4 - Përmirësimi i efijencës së energjisë në infrastrukturë	18
	OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4 - QEVERISJE EKONOMIKE EFEKTIVE DHE BASHKËPUNUESE	19
	Objektiva specifike 4.1 - Financa të pushtetit lokal të qëndrueshme dhe efektive	19
	Objektiva specifike 4.2 - Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale	20
	Objektiva specifike 4.3 - Përmirësimi i shërbimit dhe përgjegjshmërisë komunale	21
	Objektiva specifike 4.4 - Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal	22
IV.	RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE	23

Lista e shkurtesave

PNZHEL	Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal
PKZH	Plani Kombëtar për Zhvillim
PKZHR	Plani Kombëtar për Zhvillim Rural
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
PZHR	Programi për Zhvillim Rural
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
TK	Trashëgimi Kulturor
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
DSHKT	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike
QIKK	Qendrat Informativë Këshilluese Komunale
ME	Ministria e Ekonomisë
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
IT	Teknologjia e Informacionit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MATP	Masave Aktive të Tregut të Punës
PIU	Njësia për zbatimin e projekteve
EBRD	Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim
KRUM	Kompania Rajonale e Ujësullës Mitrovica
ITUZ	Impiant për Trajtim të Ujërave të Zeza
ITUN	Impiant për Trajtim të Ujërave të Ndotura
LuxDev	Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
SMPK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale
HZK	Harta Zonale Komunale
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
BERZH	Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim
LALRP	Plani i Përvetësimit të Tokës dhe Restaurimit të Jetesës
APRK	Agjencia e punësimit të Republikës së Kosovës
QAP	Qendrat e aftësimit profesional
EIB	Banka Evropiane e investimeve
WBIF	Fondi i Ballkanit Perëndimor
SECO	Zyra zvicerane për çështje ekonomike

Institucioni:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Mbikëqyrja:

Fetije Begolli, Drejtoreshë e Departamentit për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Lokal, MAPL
dhe kryesuese e komitetit zbatues

Autor:

Suzana Kosumi, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Ekonomik Lokal, MAPL dhe zv. kryesuese e komitetit zbatues

Adem Ymeti, Zyrtar i Lartë për Zhvillim Ekonomik Lokal, MAPL

Kontribues të raportit janë anëtarët e komitetit Zbatues të Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal PNZHEL 2030 të cilët i falënderojmë për bashkëpunimin: Drin Haraqia (MAPL), Flurim Arifi (MAPL), Trim Berisha (MAPL), Rasim Alija (MAPL), Besim Murtezani (MAPL), Manushaqe Mucaj (MAPL), Ekrem Ahmeti (ZKM), Ganimete Manaj (MINT), Yll Ismajli (MFPT), Zana Mehmeti (MMPHI), Fatmir Morina (ASK), Kemajl Kadriu (MBPZHR), Agim Krasniqi (MASHTI), Atifete Jakupaj (MKRS), Fatos Selimi (ME), Kreshnike Arifi (MZHR), Besarta Meha (Kryesuese e Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik Lokal), Sadri Rrmoku (KLGJ), Shpend Emini, (DEMOS).

I. HYRJE

Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, synon të lokalizojë përcaktimet strategjike që dalin nga Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim dhe strategjitë relevante sektoriale. Kryesisht fokusohet në çështje ekonomike që prekin shumicën dërrmuese të komunave, por njëkohësisht adreson edhe çështje që i takojnë nivelit qendror, të tilla që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal.

Përkundër bazës së mirë rregullative dhe përpjekjeve të bëra ndër vite, shumica e komunave të Kosovës ende nuk kanë planifikim cilësor për zhvillim ekonomik lokal dhe sfidohen me probleme të natyrave të ndryshme. Disa nga problemet janë mungesa e investimeve, shpërputhja e aftësive në tregun e punës, mungesa qëndrueshmërisë financiare dhe bashkëpunimi i kufizuar. Ky program shërben si bazë për komunat, ashtu që ato t'i hartojnë strategjitë e tyre të zhvillimit ekonomik në përputhje me kornizën strategjike ekonomike të hartuar në nivel vendi. Ky dokument është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin 14/165 të datës 12.10.2023.

Në përputhje me Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030 dhe me qëllim të përcjelljes së rregullt të zbatimit të këtij programi, MAPL-ja ka krijuar Komitetin Zbatues për PNZHEL 2030 për ta siguruar një koordinim të shëndoshë dhe efektiv midis institucioneve gjatë zbatimit. Komunitatet përfaqësohen përmes Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik Lokal.

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i procesit të zbatimit të masave të cilat dalin nga ky program dhe përcaktimi i hapave për realizimin e detyrimeve të zotuar nga institucionet e Republikës së Kosovës për avancimin e zhvillimit ekonomik lokal në vend.

Të dhënat e monitorimit mbledhen në baza vjetore. Bazuar në këto të dhëna, hartohen raporte të rregullta të progresit për të pasqyruar nivelin e zbatueshmërisë së këtij dokumenti.

Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030 ka paraparë katër objektiva kryesore:

1. **Objektiva Strategjike 1** – Ekonomi lokale konkurruese;
2. **Objektiva Strategjike 2** – Punësim gjithëpërfshirës;
3. **Objektiva Strategjike 3** – Infrastrukturë lokale e përmirësuar;
4. **Objektiva Strategjike 4** - Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese;

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti është i bazuar në 72 masa prej të cilave 10 prej tyre janë përgjegjësi e institucioneve të nivelit qendror, 27 prej tyre janë të përbashkëta pra i takojnë edhe nivelit qendror dhe nivelit lokal dhe 35 masa janë përgjegjësi e nivelit lokal të cilat duhet ti adresojnë përmes strategjive të tyre të zhvillimit ekonomik lokal, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga institucionet përfaqësuese në komitet.

Në këtë periudhë, në kuadër të objektivës strategjike të parë “**Ekonomi lokale konkurruese**”, është rritur bashkëpunimi me nivelin lokal për të promovuar dhe përkrahur investitorët e huaj për të realizuar investime në Komunitet e Kosovës. Ka filluar ndërtimi i parqeve industriale në Komunën e Drenasit, Lipjanit, Mitrovicës dhe Podujevës në vlerë prej 7.2 milion Euro. Është dizajnuar Programi për Zhvillim Rural me një buxhet prej 24.6 milionë. Në mbështetje apo subvencionim të fermerëve janë ndarë 74,447,392.00€ dhe janë ofruar këshilla informuese rreth aplikimit për subvencione dhe grante. Është aprovuar nga Qeveria koncept-dokumenti për kooperativat bujqësore dhe është finalizuar Ligji për Kooperativat Bujqësore. Në mbështetje të prodhimit bujqësor janë realizuar trajnimevepër rritje të aftësive për kultivim të qëndrueshëm dhe efikas. Gjithashtu është hartuar drafti i udhëzimit administrativ për Brendin dhe Simbolin Shtetëror të Turizmit të Kosovës i cili parashihet edhe me Ligjin e turizmit. Ndërsa në Trashëgimi Kulturorë (TK) është investuar në 78 projekte kapitale në vlerë prej 6,499,684.61€.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ka organizuar një trajnim të dedikuar për zyrtarët komunalë, të fokusuar në shfrytëzimin dhe përdorimin e platformës e-Komuna si mjet kyç për digjitalizimin e shërbimeve komunale i cili ndikon në automatizimin e proceseve administrative, si dhe në përmirësimin e cilësisë, transparencës dhe pranueshmërisë së shërbimeve për qytetarët.

Në pajtim me objektiven e dytë të strategjisë “**Punësim gjithëpërfshirës**” janë hartuar dhe janë në zbatim 16 profile profesionale në sistemin dual të arsimit, të cilat janë duke u zbatuar në shkollat profesionale dhe qendrat e aftësimin profesional në Republikën e Kosovës.

Këto profile janë zhvilluar në bazë të analizave të tregut të punës dhe nevojave të sektorëve ekonomik prioritarë, në bashkëpunim me akterët relevantë të tregut të punës, përfshirë bizneset, odat ekonomike dhe partnerët social. Programet mësimore janë strukturuar sipas modelit të arsimit dual, duke integruar mësimin teorik në institucionet arsimore me mësimin praktik në ndërmarrje.

Gjatë vitit 2025, në kuadër të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP), kanë përfituar 1,287 gra dhe 1,446 të rinj të moshës 15–29 vjeç.

Fokus i veçantë është dhënë edhe në avancimin e infrastrukturës lokale bazuar në objektiven e tretë të programit **“Infrastrukturë lokale e përmirësuar”** ku zhvillimi i infrastrukturës lokale, përpos ndikimit në përmirësim të jetës së qytetarëve, luan një rol qenësor edhe në rritje ekonomike. Në këtë drejtim janë në proces të zbatimit projektet si në vijim: “Ndërtimin e impiantit rajonal për trajtimin e ujërave të ndotura të Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës”, “Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Mitrovicë (Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Vushtrri, Zveçan)”, “Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Gjilan”.

Gjatë vitit 2025, masat e efijencës së energjisë janë zbatuar në 17 ndërtesa publike në pronësi të gjashtë komunave (Istog, Suharekë, Podujevë, Lipjan, Shtime dhe Viti), me një vlerë totale investimi prej 3,727,801.00€. Projektet aktualisht janë në fazën e inaugurimit të ndërtesave publike. Në tërësi, masat e zbatuara pritet të gjenerojnë kursime vjetore të energjisë prej 5,416 MWh dhe të kontribuojnë në reduktimin e emetimeve të CO₂ prej rreth 522 tonë në vit, duke përmirësuar përdorimin e energjisë në sektorin publik dhe duke mbështetur objektivat për menaxhim të qëndrueshëm të energjisë. Bazuar në objektiven katër të strategjisë **“Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese”**, në vitin 2024 është realizuar regjistrimi i popullsisë i cili ka reflektuar edhe në ndryshimin e financimit të komunave për vitin 2025.

Në zbatim të masave të cilat përgjegjëse janë komunat bazuar në kapitullin 8, Zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi-Zbatimi i PNZHEL 2030 do të bëhet përmes strategjive të zhvillimit ekonomik lokal dhe planeve të tyre të veprimit të hartuara nga komunat, si dhe përmes planeve institucionale të ministrive. Gjendja e strategjive komunale për Zhvillim Ekonomik Lokal është: 7 komuna kanë hartuar strategjinë për zhvillim ekonomik lokal: Prizreni, Klina, Lipjani, Skenderaji, Drenasi, Ferizaji, Kamenica; 8 komuna janë në proces të hartimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal: Deçani, Suhareka, Fushë Kosova, Gjilani, Graçanica, Kaçaniku, Juniku, Rahoveci; 2 komuna të cilat kanë strategji valide por nuk e kanë të harmonizuar me PNZHEL janë: Shtime dhe Hani i Elezit; 20 komuna nuk kanë strategji për zhvillim ekonomik lokal: Dragashi, Mamusha, Peja, Istogu, Novobërda, Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku, Leposaviqi, Gjakova, Prishtina, Mitrovica Jugore, Vushtrria, Malisheva, Obiliqi, Klllokoti, Ranillugu, Shtërpca, Parteshi, Podujeva.

III. ZBATIMI I MASAVE TË PROGRAMIT NACIONAL PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2030

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1 – EKONOMI LOKALE KONKURRUESE **Objektiva specifike 1.1 - Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal**

Për të ndihmuar në zhvillimin e një ekonomie lokale konkurruese në kuadër të masës

1.1.1. Hartimi i profileve ekonomike dhe materialeve të tjera promovuese të komunave ku tregohen potencialet për investime - Komunitat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr iniciativë për hartimin e profileve ekonomike. Në këtë periudhë të raportimit këto profile janë hartuar nga: Istogu, Hani i Elezit, Podujeva, Gjilani dhe Drenasi. Gjithashtu Ministria e Zhvillimit Rajonal në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale kanë përgatitur materiale promovuese për monitorimin e performancës komunale në kuadrin e agjendës së gjelbër të iniciativës "Nismat lokale dhe rajonale për zhvillim të qëndrueshëm".

1.1.2. Ngritja e resurseve njerëzore brenda komunave për t'i promovuar investimet - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të OSBE-së, ka realizuar takim me përfaqësues të komunave lidhur me procesin e menaxhimit të projekteve kapitale të financuara nga programet e MAPL-së, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit dhe përfitimit të investimeve të reja.

1.1.3. Ngritja e kapaciteteve komunale për qasje në fonde zhvillimore - Ministria e Zhvillimit Rajonal ë bashkëpunim me Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale kanë trajnuar zyrtarë pjesëmarrës nga 7 komuna: Fushë Kosovë, Drenas, Graçanicë, Lipjan, Obiliq, Prishtinë, Podujevë, për qasje në fonde zhvillimore me iniciativën "Nismat lokale dhe rajonale për zhvillim të qëndrueshëm".

1.1.4. Lehtësira të tatimit në pronë për stimulim të investimeve të natyrës më strategjike - Gjatë vitit 2025 nuk ka pasur ndryshime sa i përket kësaj mase. Aktualisht është në proces hartimi i Ligjit të ri për tatimin në pronë, në kuadër të të cilit pritet të shqyrtohen mundësitë për përfshirjen e lehtësirave që do të mund të kontribuonin në stimulimin e investimeve të natyrës strategjike.

1.1.5. Klasifikimi më i mirë i pronës komunale për dhënie në shfrytëzim- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka filluar Hartimin e Projektligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i cili Ligj do të adresoj sfidat e identifikuar në zbatim të Ligjit aktual lidhur me procesin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim.

1.1.6. Thjeshtimi i procedurave për kalim të pronës nga AKP-ja të komunat - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

1.1.7. Thjeshtimi i procedurave për promovimin e iniciativave të partneritetit publiko privat - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitete, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

1.1.8. Krijimi i mundësisë që komunat të ofrojnë garanci kreditore për ndërmarrjet, ashtu që të përmirësohet qasja e tyre në financa - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitete, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

1.1.9. Krijimi i parqeve industriale të specializuara me veçori miqësore për mjedisin- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka ndërmarrë veprime lidhur me funksionalizimin e parqeve si në vijim: Parkut të Përgjithshëm Industrial në Drenas 2, me një sipërfaqe prej 36.5 hektarësh, është kontraktuar Operatori Ekonomik për ndërtimin e parkut dhe kanë filluar punimet.

Në Parkun Industrial në Qylagë të Lipjanit, kanë vazhduar punimet drejt finalizimit të Fazës IV të ndërtimit të infrastrukturës fizike, me një vlerë prej 600,000.00€. Aktualisht, është në fazën e përgatitjes, faza e radhës për ndërtimin e mëtejshëm të infrastrukturës së këtij parku, për të cilën janë ndarë mjete shtesë në vlerë prej mbi 2 milionë euro. Për Parkun Industrial në Frashër të Mitrovicës, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Mitrovicës dhe janë ndarë mjete në vlerë prej 1.1 milion €. Është nënshkruar marrëveshja edhe me Komunën e Podujevës dhe janë ndarë mjete në vlerë prej 3.5 milionë € për periudhën 2024–2026, për ndërtimin e infrastrukturës fizike të parkut.

Objektiva specifike 1.2 - Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal

Në funksion të zbatimit të masës **1.2.1. Ofrimi i granteve për pajisje në bujqësi me kusht bashkimin e parcelave** - Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit Kombëtar për Zhvillim Rural 2023-2027 (Grante-2024), ka paraparë buxhetin indikativ për zbatimin e këtij Programi rreth 24.627 milionë €. Ky Program parasheh ofrimin e mbështetjes së investimeve në sektorin agrorural përmes këtyre masave: - Masa 1: Investime në asete fizike dhe ekonomi familjare; - Masa 3: Investime në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore; - Masa 5: Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal (qasja LEADER); - Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve (zbatohet nga GIZ me rreth 10 milionë €). Programi për vitin 2024 ka paraparë një investim rreth 19,627 milionë €, për të cilin kanë aplikuar 1072 aplikues, ndërsa grant kanë përfituar rreth 463 fermerë me një vlerë të përgjithshme prej 14.419,394,54€, të vlerësuara dhe përzgjedhur në zbatim gjatë vitit 2025. Përfituesit kanë përfituar grante për sektorët si pemëtaria, perimtaria, blegtoria, përpunimi i qumështit dhe mishit, si dhe ndërtimi i infrastrukturës bujqësore. Ndërsa për të njëjtat masa PZHR për vitin 2025 ka paraparë buxhet investimi prej mbi 26 milionë €, i cili pritet të zbatohet përgjatë vitit 2026.

Zbatimi i masës **1.2.2. Rritja e subvencionimit direkt në bujqësi me procedura më të thjeshtuara** - PKZHR 2023-2027, i cili zbatohet përmes PZHR 2024, parasheh ofrimin e mbështetjes për ekonomitë bujqësore sipas masave dhe atë: - Masa 1: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore; - Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore; ndërsa sa i përket Masës 5: Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - Qasja "Leader" dhe Masës "Mbështetja për masat e menaxhimit të rrezikut në bujqësi (Sigurimet bujqësore) mbetet që fermerët do të njoftohen në të ardhmen. Prandaj, në mbështetje të thirrjes përmes procedurave të thjeshtuara kanë aplikuar për mbështetje direkte mbi 33,731 fermer nga sektor të ndryshëm sipas masave mbështetëse. Nga ky numër kanë përfituar 32,090 fermer për kultura të ndryshme bujqësore, ndërsa janë refuzuar 1,641 aplikues. Të gjithë fermerët përmes Agjencisë të Zhvillimit të Bujqësisë kanë mbështetje në vlerë prej 74,447,392.00€.

Masa **1.2.3 Ofrimi i mbështetjes për formimin e kooperativave bujqësore moderne me fokus të veçantë për gratë pronare** - Përmeshja e kësaj mase ka qenë e kufizuar për shkak të mungesës së legjislacionit mbështetës, çka ka pamundësuar ofrimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë për formimin dhe funksionalizimin e kooperativave bujqësore moderne, përfshirë edhe ato me fokus të veçantë për gratë pronare. Në kuadër të zhvillimeve për zbatimin e kësaj mase, MBPZHR ka nxjerrë Projektligjin për Kooperativat Bujqësore dhe draft statutet e tyre, bazuar në bazën e Koncept-Dokumentit për Kooperativat Bujqësore, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 prill 2025. Projektligji ka kaluar të gjitha fazat e diskutimeve publike, përfshirë edhe analizën e komenteve të pranuar. Drafti i Ligjit është plotësuar nga DSHKT. Krahasuar me vitin 2024, nuk është shënuar progres i drejtpërdrejtë në zbatimin praktik të kësaj mase, megjithatë, avancimi i procesit ligjvënës përbën një hap të rëndësishëm drejt krijimit të bazës ligjore për zbatimin e saj në periudhat e ardhshme, përfshirë edhe mbështetjen e strukturuar për gratë pronare në kuadër të kooperativave bujqësore.

1.2.4 Fuqizimi i zyrave këshilluese për t'i ndihmuar fermerët në proces të aplikimit për grante- Janë shënuar arritje të rëndësishme në forcimin e kornizës ligjore, institucionale dhe operacionale të shërbimeve këshillimore. Janë hartuar: Ligji për Kooperativat Bujqësore dhe draft-statutet përkatëse; draft-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Këshillimor; udhëzimi administrativ për certifikimin e këshilltarëve si dhe Termat e Referencës për sistemin informativ-digjital të shërbimit këshillimor. Janë organizuar trajnime për 30 këshilltarë publikë, janë shpërndarë 25 mesazhe informative për fermerët dhe janë përgatitur e prezantuar rezultatet nga fushat demonstrative të grurit. Në aspektin e zbatimit praktik, shërbimet këshillimore kanë ofruar mbështetje direkte për fermerët përmes pranimit të 14,983 aplikacioneve për subvencione dhe grante,

informimit të 7,598 fermerëve dhe përkrahjes së drejtpërdrejtë të 5,881 fermerëve në procesin e aplikimit, duke përfshirë përgatitjen e 482 projekteve për grante.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural, janë funksionalizuar qendra në 27 komuna: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Glllogoc, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë. Ndërsa, për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së bujqësisë, është ofruar mbështetje për 9,454 fermerë në sektorët: bletarisë, blegtorisë, perimtarisë, pemëtarisë, bimëve foragjere dhe hortikulturës në 27 komuna: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Gjilan, Glllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillugë, Shtime, Shtërpce, Skenderaj, Suharekë, Viti, Kamenicë.

Me zbatimin e masës **1.2.5 Trajnime për fermerët për ngritje të aftësive për kultivim më efikas të prodhimeve bujqësore** -Në kuadër të kësaj mase janë ofruar këshilla teknike dhe trajnime për 3,175 fermerë në teren dhe 6,535 fermerë në zyra. Janë realizuar 200 trajnime me 2,147 fermerë, janë organizuar 13 vizita “fermeri te fermeri” me 347 pjesëmarrës dhe janë përkrahur 40 këshilltarë publikë dhe 350 grupe fermerësh. Në drejtim të informimit dhe ngritjes së kapaciteteve, janë shpërndarë 4,891 broshura dhe fletëpalosje, janë botuar 8 tituj broshurash (24,000 ekzemplarë) dhe 2 udhëzues teknikë (600 ekzemplarë), janë realizuar 9 video tematike dhe është zhvilluar faqja zyrtare e shërbimeve këshillimore. Për më tepër, janë organizuar vizita studimore për 14 këshilltarë publikë dhe janë përgatitur plane mujore dhe vjetore të trajnimeve, duke përmirësuar koordinimin ndërmjet DSHKT dhe QIKK dhe duke kontribuar në forcimin e shërbimeve këshillimore dhe zhvillimin rural të qëndrueshëm.

1.2.6. Përmirësimi i zinxhirit të vlerës në bujqësi përmes përkrahjes së pikave grumbulluese- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

Masa 1.2.7. Brendimi turistik i komunave (logoja, slogani, identiteti vizual dhe narracioni turistik në përgjithësi)- Departamenti i Turizmit në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka hartuar draftin e udhëzimit administrativ për Brendin dhe Simbolin Shtetëror të Turizmit të Kosovës i cili parashihet edhe me ligjin e turizmit.

1.2.8. Krijimi dhe funksionalizimi i qendrave informative për promovimin e turizmit lokal- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive

komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

1.2.9. Përmirësimi i infrastrukturës lokale në zonat turistike- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

Masa 1.2.10 Restaurimi i hapësirave të trashëgimisë kulturore dhe rimodelimi i tyre për ta promovuar ekonominë kreative- MKRS përmes departamentit të Trashëgimisë Kulturore gjatë vitit 2025, me qëllim të zbatimit të masës 1.2.10 ka investuar në 78 projekte kapitale dhe ka shpenzuar masën monetare prej 6,499,684.61€. Në vitin 2025 janë të përfunduara 34 projekte, në proces të zbatimit janë 50 projekte kapitale, në procedure të prokurimit janë 37 projekte kapitale, dhe 10 projekte janë në proces të hartimit. Investimet janë realizuar pothuajse në gjitha Komunat e Kosovës në: restaurime, konservime, revitalizim dhe funksionalizim të aseteve të trashëgimisë kulturore. Po në vitin 2025 MKRS ka funksionalizuar përmes thirrjeve publike-subvencione dhe transfere një numër të objekteve të Trashëgimisë Kulturore (janë projekte tri vjeçare) si: Shtëpia e Katarina Josipit-Zym-Prizren, Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit- Boletin -Mitrovicë, Ish Burgu i Prishtinës - Burgu i Idealit Prishtinë, Galeria e Agim Çavdarbashës- Prishtinë. Asetet e trashëgimisë kulturore përveç ruajtjes, mbrojtjes së vlerave të tyre, në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë kontribuojnë edhe në zhvillim të ekonomisë kreative në Kosovë.

Objektiva specifike 1.3 - Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion

1.3.1. Ofrimi i mbështetjes për themelimin e qendrave të inovacionit të specializuara në veprimtari të zonës- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

1.3.2. Mbështetja e trajnimeve për përparësitë e digjitalizimit të proceseve dhe dobitë e ekonomisë qarkore - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ka organizuar një trajnim të dedikuar për zyrtarët komunalë, stafin e teknologjisë së informacionit (IT), zyrtarët e zyrave për informim dhe zyrtarë të tjerë relevantë në nivel lokal.

Trajnimi është fokusuar në shfrytëzimin dhe përdorimin e platformës e-Komuna si mjet kyç për digjitalizimin e shërbimeve komunale në rritjen e kapaciteteve profesionale për menaxhimin dhe

automatizimin e proceseve administrative, si dhe në përmirësimin e cilësisë, transparencës dhe pranueshmërisë së shërbimeve për qytetarët. Gjithashtu në bashkëpunim me IKAP-in është realizuar trajnimi “Menaxhimi i kontratave në platformën elektronike”.

1.3.3. Ofrimi i granteve për ndërmarrje të reja inovative (ndërmarrjeve në pronësi të grave t'u jepet përparësi)- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

1.3.4. Ofrimi i shpërblimeve vjetore për ndërmarrjet lokale më inovative- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2 – PUNËSIM GJITHËPËRFSHIRËS;

Objektiva specifike 2.1 - Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës

2.1.1. Krijimi i këshillave komunale për artikulum të nevojave të sektorit privat - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

2.1.2. Fuqizimi i zyrave të punësimit - Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, e cila është institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj mase gjatë vitit 2025 ka rekrutuar 20 këshilltar për punësim.

Tek masa 2.1.3 Përshtatja e programeve dhe kurrikulave në shkolla profesionale dhe qendra të aftësimin profesional me nevojat e tregut- MASHTI, në kuadër të reformës së arsimit dhe aftësimin profesional, ka hartuar dhe miratuar 16 profile profesionale në sistemin dual të arsimit, të cilat janë duke u zbatuar në shkollat profesionale dhe qendrat e aftësimin profesional në Republikën e Kosovës. Këto profile janë zhvilluar në bazë të analizave të tregut të punës dhe nevojave të sektorëve ekonomikë prioritarë, në bashkëpunim me akterët relevantë të tregut të punës, përfshirë bizneset, odat ekonomike dhe partnerët socialë. Programet mësimore janë strukturuar sipas modelit të arsimit dual, duke integruar mësimin teorik në institucionet arsimore me mësimin praktik në ndërmarrje.

Zbatimi i këtyre profileve kontribuon në përshtatjen e kurrikulave profesionale me kërkesat reale të tregut të punës, rritjen e punësueshmërisë së nxënësve dhe forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit profesional dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Gjithashtu në APRK funksionojnë 7 qendra të aftësimin profesional, vazhdimisht zhvillohen dhe rishikohen kurrikula në bashkëpunim me sektorin privat, duke i përshtatur ato me standarde të profesionit dhe në nevojat e tregut të punës. Zhvillohen

apo rishikohen se paku 3 kurrikula në vit. Në vitin 2025 janë zhvilluar standarde te profesionet dhe kurrikulat me pjesëmarrje aktive edhe të përfaqësuesve të tregut me qëllim që kurrikulat të jenë të përshtatura me nevojat në tregun e punës. Në vitin paraprak janë zhvilluar kurrikula për: instalues dhe mirëmbajtës të paneleve solare; teknik të rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike dhe riparues të pajisjeve elektro-shtëpiake.

2.1.4. Mbështetja e trajnimeve në vend të punës ose formave tjera të trajnimeve- QAP-të për disa nga kualifikimet kanë marrëveshje bashkëpunimi me biznese për trajnim të kandidatëve për pjesën praktike të kurrikulës në kompani. Gjithashtu APRK në bashkëpunim me donatorë, kontraktin trajnime te ofruesit privat të trajnimeve për kualifikime që kërkon tregu dhe në QAP nuk organizohen ato trajnime.

Objektiva specifike 2.2 - Rritja e punësimit të dinjitetshëm për gra, të rinj dhe kategori të cenueshme

2.2.1. Mentorimi i të rinjve dhe grave të papuna nga diaspora, për t'iu përmirësuar mundësitë për vetëpunësim-Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program. Në funksion të zbatimit të masës **2.2.2. Prioritizimi i grave dhe të rinjve në përkrahjen për punësim përmes MATP-** Gjatë vitit 2025, në kuadër të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP), është evidentuar një fokus i vazhdueshëm në përfshirjen e grave dhe të rinjve në programet e punësimit. Në total, 1,287 gra dhe 1,446 të rinj të moshës 15–29 vjeç kanë përfituar nga këto masa, duke reflektuar orientimin e politikave drejt rritjes së pjesëmarrjes së këtyre kategorive në tregun e punës dhe mbështetjes së tyre në integrim më të qëndrueshëm ekonomik.

Masa 2.2.3. Krijimi i panairove të punës me fokus punësimin e grave dhe të rinjve- Gjatë vitit 2025 është organizuar Panairi Kombëtar i Punës dhe Karrierës në Prishtinë, në bashkëpunim me GIZ. Ky panair ka shërbyer si një platformë e rëndësishme për lidhjen e punëkërkuësve me punëdhënësit, duke ofruar mundësi konkrete për informim mbi vendet e lira të punës, zhvillim të rrjeteve profesionale dhe orientim në karrierë.

Në kuadër të këtij aktiviteti, është vendosur theks i veçantë në përfshirjen e grave dhe të rinjve, me qëllim rritjen e qasjes së tyre në tregun e punës dhe promovimin e mundësive të barabarta për punësim.

2.2.4. Ofrimi i qasjes së konvencionale në kujdes ditor për fëmijë dhe të moshuar, për të mundësuar qasjen e grave në treg të punës. Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3 – INFRASTRUKTURË LOKALE E PËRMIRËSUAR

Objektiva specifike 3.1 - Përmirësimi infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve

3.1.1. Ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruktimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale- Bazuar në raportin e fundit të performancës së komunave, fusha 9 – infrastruktura rrugore performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 57.08%. Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Kjo fushë përmban tregues të pasqyrojnë rezultatet e komunave në aspektin e mirëmbajtjes së rrugëve gjatë dimrit dhe verës, pastaj riasfaltimin e rrugëve, shtigjet me biçikleta, trotuareve, ndriçim publik dhe shenjëzim vertikal dhe horizontal.

3.1.2. Përmirësimi i infrastrukturës sinjalistike në komunikacion- Bazuar në raportin e fundit të performancës së komunave, fusha 9 – infrastruktura rrugore treguesi - gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal është vlerësuar në shkallë prej 64.54%.

3.1.3. Krijimi i hapësirave të reja të parkingut publik - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

3.1.4. Digjitalizimi i shërbimeve në stacionet e autobusëve - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

3.1.5. Përkrahja e investimeve në transport alternativ -Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

3.1.6. Organizimi i transportit publik lokal në komuna më të mëdha (aty ku mungon)-Bazuar në raportin e fundit të performancës së komunave fusha 10 – transporti publik, kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 43.10%.

Objektiva specifike 3.2 -Sigurimi i qasjes në infrastrukturë përcjellëse

3.2.1. Ndarja e më shumë mjeteve financiare për rregullimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe drenazhit - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

3.2.2. Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza- ME ka raportuar se është në proces të zbatimit të projekteve si në vijim:

1. "Ndërtimi i impiantit rajonal për trajtimin e ujërave të ndotura të Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës"- është bërë definimi i kriterëve të dizajnit, si dhe është dorëzuar drafti i parë i dizajnit preliminar/konceptual. PIU ka kryer kontrollimin dhe ka dërguar komentet te kompania konsulente. Më pas, kompania konsulente ka vazhduar me rishikimin/revidimin e projektit në përputhje me komentet e marra nga PIU dhe nga Institucioni Financues Ndërkombëtar, dhe në fund të muajit dhjetor 2025 ka dorëzuar draftin e dytë të dizajnit preliminar. Raportet e ndikimit mjedisor dhe socioekonomik janë në zhvillim e sipër. Burimi i financimit: Kredi: 53.3 milion DGT (Thesari Francez) firmosur deri 66 milion, Kredi + Grant: 20 milion AFD (kredi) +90 milion WBIF (grant).

2. "Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Mitrovicë (Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Vushtrri, Zveçan)". Komuna ka rekomanduar që impianti të ndërtohet në lokacionin e paraparë me PZHK (Plani Zhvillimor Komunal). Ministritë e përfshira në projekt kanë rekomanduar që të analizohen edhe hapësira të tjera për ndërtimin e impiantit. Pas marrjes së konfirmimit nga Banka se mund të vazhdohet me studimin e alternativave për vendndodhjen, më 14.03.2025, janë nënshkruar tri (3) marrëveshje shumë të rëndësishme për projektin e ujërave të ndotura në Mitrovicë: Marrëveshja me komunat Mitrovicë dhe Vushtrri – EBRD dhe KRUM – Projekti për Zhvillimin e Ujërave të Ndotura; Marrëveshja e nën-grantit për projektin “Zhvillimi i Ujërave të Ndotura në Mitrovicë” ndërmjet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe KRU Mitrovicës; Memorandum Bashkëpunimi me komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe KRUM për projektin “Zhvillimi i Ujërave të Ndotura në Mitrovicë”. Konsulenca ka përfunduar studimin – analizën për katër (4) lokacione dhe ka dërguar Raportin Gjithëpërfshirës të Studimit për Alternativat, i cili është ndarë me të gjitha palët e përfshira. Është përcaktuar vendndodhja për ndërtimin e impiantit, pasi të gjitha palët e përfshira në projekt janë pajtuar me analizën/studimin e alternativave se M1 është vendndodhja e preferuar për ndërtimin e ITUN-it. Nga konsulenca është kërkuar përditësimi i dokumentacionit. Konsulenca është angazhuar që të bëjë përditësimet e dizajnit konceptual të impiantit dhe rrjetit të kanalizimit, në përputhje me rrethanat e reja dhe përshtatjen me lokacionin e

ri – M1. Aktualisht kanë filluar vizitat në terren për analizë dhe përshtatje me lokacionin e ri. Burimi i financimit: Kredi, EIB 19,800,000€ dhe BERZH 13,500,000 €; Grant WBIF 5,700,000€ dhe SECO 337,500€, Total i siguruar deri tani: 39,337,500€.

3. "Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Gjilan"- gjatë vitit raportues, në kuadër të projektit ITUN, janë realizuar aktivitete të rëndësishme administrative, teknike dhe përgatitore, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për fillimin e fazave ndërtimore. Në kuadër të detyrave të rregullta mujore është përgatitur dhe dorëzuar në BERZH, në bashkëpunim me konsulentin e PIUsë, raporti LALRP (Land Acquisition and Livelihood Restoration Plan) për projektin e ITUZ. Po ashtu, është përgatitur shkresa për pajisje me ekstrakt nga Instituti i Planifikimit Hapësinor të Kosovës, si dhe është hartuar dhe dorëzuar plani shumëvjeçar për shpenzimin e fondeve për këtë projekt. Një komponentë e rëndësishme ka qenë edhe përgatitja dhe dorëzimi i Annual Environmental & Social Report për vitin 2024, si dhe koordinimi i vazhdueshëm me Komunën e Gjilanit dhe atë të Parteshit për proceset e shpronësimit dhe lejeve të kalimit për rrjetin e kanalizimit. Në aspektin e prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar vlerësimet teknike për tre tenderë kryesorë: mbikëqyrjen e punimeve, ndërtimin e ITUZ-it dhe zgjerimin/rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit. Këto vlerësime janë dorëzuar në BERZH, ku është marrë aprovimi përfundimtar për tenderët e mbikëqyrjes dhe të rrjetit të kanalizimit, si dhe aprovimi në parim për ndërtimin e ITUZ-it – Faza I, operatorët ekonomikë fitues për mbikëqyrje dhe ndërtimin e kolektorëve kanë pranuar njoftimet për kontratë dhe ka filluar procesi i negocimit. Gjatë TM4, aktivitetet janë intensifikuar me përgatitjen e dokumentacionit për leje ndërtimore për kolektorët, finalizimin e raportit për leje mjedisore komunale dhe lansimin e tenderit "Stage 2" për ndërtimin e ITUZ-it. Është nënshkruar Amendamenti Nr. 1 i kontratës së mbikëqyrjes dhe është mbajtur takimi fillestar me kontraktorin. Në fillim të muajit dhjetor është caktuar commencement date, duke shënuar zyrtarisht fillimin e punimeve në terren për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, pas sigurimit të lejeve ndërtimore nga Komuna e Gjilanit. Burimi i financimit: EBRD -10mil €-Kredi , EIB-11mil € Kredi, WBIF Grand-2.5mil €, WBIF-Grand-0.6 mil € , SECO Grand-0.3 mil €.

4. Impianti i ujërave të ndotura Ferizaj- Sipas afateve të dhëna nga EBRD faza e parakualifikimit ka filluar më datë 24.10.2025. Afati për dorëzimin e ofertave për parakualifikim ka qenë deri më 16.12.2025. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej pesë (5) oferta, të cilat aktualisht janë në proces vlerësimi nga anëtarët e PIU të KRU Bifurkacionit. Burimi i financimit: 20,000,000.00 €-EBRD, 10,000.000.00 €-WBIF (në aplikim)

Objektiva specifike 3.3 - Menaxhimi i integruar i mbeturinave

3.3.1. Rritja e përkrahjes nga niveli qendror për ngritjen e kapaciteteve për menaxhim dhe operim të mirëfilltë të ndërmarrjeve publike rajonale për menaxhim të mbeturinave - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitete, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

Me qëllim të zbatimit të masës **3.3.2. Zhvillimi i planeve ndërkomunale për menaxhim të integruar të mbeturinave** - Janë shqyrtuar draftet e planeve ndërkomunale për menaxhim të mbeturinave për rajonet e Gjilanit, Ferizajit dhe Pejë.

3.3.3. Zhvillimi i rrjetit të stacioneve të transferimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave përmes inicativave ndërkomunale - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimin të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

3.3.4. Krijimi i qendrave të riciklimit dhe kompozimit të mbeturinave në bazë të analizave të fizibilitetit dhe planeve të integruara-Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitete, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

3.3.5. Rritja e vetëdijes për dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimin të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

3.3.6. Ofrimi i granteve për inovacion që e promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në gjetjen e alternativave ndaj ambalazhit dhe produkteve plastike- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimin të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

3.3.7. Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe komunave në trajtim, riciklim dhe ripërdorim të fraksioneve të caktuara të mbeturinave- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimin të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

Objektiva specifike 3.4 - Përmirësimi i efijencës së energjisë në infrastrukturë

3.4.1 Renovimi i ndërtesave publike komunale, për ta përmirësuar efijencën e tyre- 1.

Gjatë vitit 2025, masat e efijencës së energjisë janë zbatuar në 17 ndërtesa publike në pronësi të gjashtë komunave: Istog, Suharekë, Podujevë, Lipjan, Shtime dhe Viti, me një vlerë totale investimi prej 3,727,801.00€. Projektet aktualisht janë në fazën e inaugurimit të ndërtesave publike. Në tërësi, masat e zbatuara pritet të gjenerojnë kursime vjetore të energjisë prej 5,416 MWh dhe të kontribuojnë në reduktimin e emetimeve të CO₂ prej rreth 522 tonë në vit, duke përmirësuar përdorimin e energjisë në sektorin publik dhe duke mbështetur objektivat për menaxhim të qëndrueshëm të energjisë. Këto aktivitete kanë kontribuar në uljen e ndikimeve mjedisore dhe në realizimin e qëllimeve të strategjisë, duke promovuar një përdorim më të qëndrueshëm dhe efikas të energjisë në nivel kombëtar. Njëkohësisht, me zhbllokimin e masave, do të nisë edhe zbatimi i masave të efijencës së energjisë në 17 ndërtesa të tjera publike, duke zgjeruar më tej ndikimin e programit.

2. Me një buxhet prej 6.4 milionë € është kryer zbatimi i masave e efijencës së energjisë në 28 ndërtesa shumë banesore në pronësi të Komunave: Skenderaj, Malishevë, Drenas, Gjilan, Kamenicë, Viti, Obiliq, Istog, Klinë, Prishtinë, Lipjan, Mitrovicë, dhe Prizren. Në ndërtesat sociale shumë banesore, kanë përfituar 785 familje, ndërkaq kursimet prej 6.2 GWh/vit janë rezultat i përmirësimeve në sistemet e ngrohjes dhe izolimin e ndërtesave, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit në sektorin e ndërtimit.

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA, komunat kanë avancuar politikat e efijencës së energjisë. Planin për Efijencë të Energjisë e kanë miratuar 18 komuna: Deçan, Dragash, Junik, Gjilan, Glllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Malishevë, Mamushë, Obiliq, Partesh, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Viti.

Me qëllim të zbatimit të Planit për Efijencë të Energjisë, komunat kanë nisur një sërë projektsh konkrete për përmirësimin e performancës energjetike të objekteve publike dhe infrastrukturës. Nga të dhënat e ofruara, 22 komuna: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Glllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë, Viti dhe Kamenicë, kanë raportuar aktivitete konkrete (renovime, vendosje panele diellore, ndriçim LED, izolime, etj).

3.4.2.Rehabilitimi i ndriçimit të rrugëve me teknologji LED- Komuna e Malishevës ka investuar në 81 copë trupa ndriçues në vlerë financiare prej 10,000.00€. Komuna e Drenasit në vitin 2025 ka investuar në rehabilitimin e ndriçimit publik me trupa LED, ku janë vendosur 1,249 trupa LED, me vlerë prej: 238,029.60€. Komuna e Gjakovës në vitin 2025 ka vendosur 1500 copë drita LED 50w në vlerë prej 105,000.00€, ndërsa drita 100w 300 copë në vlerë prej 27,000.00€.

3.4.3. Ofrimi i stimujve për përdorimin e paneleve solare në objekte afariste - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Ministria e Ekonomisë (ME) dhe Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor (LuxDev), më datë 10.09.2025 kanë nënshkruar marrëveshjen për skemën e granteve për energji të pastër. Qëllimi i kësaj skeme është të stimulojë angazhimin e sektorit privat në tranzicionin energjetik të Kosovës duke përdorur teknologji të qëndrueshme të prodhimit, duke rritur eficiencën e energjisë dhe duke ulur kostot operative. Në këtë skemë kanë aplikuar Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim që të bëhen pjesë e Skemës së Granteve për Energji të Pastër. Përveç tyre, të drejtë aplikimi kanë edhe bizneset e mëdha që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim. Vlera totale e skemës është 1,000,000.00€ e financuar nga Qeveria e Luksemburgut.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4 - QEVERISJE EKONOMIKE EFEKTIVE DHE BASHKËPUNUESE

Objektiva specifike 4.1 - Financa të pushtetit lokal të qëndrueshme dhe efektive

4.1.1. Rishikimi i kushteve dhe kriterëve për të përcaktuar banorët rezidentë në komune për të ndarë më mirë fondet qeveritare- Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024 ka realizuar regjistrimin e Popullsisë, i cili regjistrim ka reflektuar edhe në ndryshimin e financimit të komunave për vitin 2025 dhe vitin 2026. Megjithatë varshmëria financiare e komunave nga Grandet e Qeverisë ende mbetet e madhe dhe komunat duhet të bëjnë përpjekje për rritje të të hyrave vetanake dhe shqyrtimin e mundësive për pavarësi financiare bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Është draftuar Plotësim /ndryshimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal i cili draft Ligj ka trajtuar rishikimin e granteve specifike dhe ka propozuar grande të reja me qëllim të ndarjeve me të drejta të financimit komunal. Ky Ligj ka kaluar procesin e konsultimeve por ende nuk është aprovuar në Qeveri.

4.1.2. Rishikimi i politikave buxhetore për grantet specifike bazuar në kompetenca- Është draftuar Plotësim /ndryshimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal i cili draft Ligj ka trajtuar rishikimin e granteve specifike dhe ka propozuar grande të reja me qëllim të ndarjeve me të drejta të financimit komunal. Ky Ligj ka kaluar procesin e konsultimeve por ende nuk është aprovuar në Qeveri.

4.1.3. Të avancohet buxhetimi i përgjegjshëm gjinor- Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitete, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

4.1.4. Rritja e fleksibilitetit në shpenzime operative- Ministria e Financave/ Departamenti i buxhetit tashmë e ka adresuar këtë masë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo vit fiskal

zhvillohen konsultime buxhetore me komunat (forume me komunat), gjatë të cilave merren parasysh prioritetet e tyre në përcaktimin e strukturës së shpenzimeve. Në këtë mënyrë sigurohet një nivel i caktuar fleksibiliteti në planifikimin e shpenzimeve operative.

4.1.5. Rritja e gamës së të hyrave vetanake duke vendosur tarifa/taksa shtesë, si p.sh: për mbrojtjen e mjedisit, për shit-blerjen e patundshmërive apo në rastin e trashëgimisë - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

4.1.6. Krijimi i mekanizmave për grumbullim më të mirë të llogarive të arkëtueshme - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

4.1.7. Organizimi i fushatave vetëdijësuese për rritjen e shkallës së inkasimit të të hyrave vetanake- Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

4.1.8. Krijimi kushteve ligjore për të lehtësuar huamarrjen e komunave- Gjatë vitit 2025, Departamenti Ligjor i MFPT në bashkëpunim me departamentet përkatëse dhe Thesarin, ka draftuar Rregulloren që rregullojnë procedurat dhe kriteret për borxh qeveritar dhe komunal, përfshirë edhe aspektet që ndërlidhen me huamarrjen e komunave. Draftet janë dërguar për shqyrtim të mëtejshëm, mirëpo ende nuk kanë kaluar fazën e konsultimeve publike dhe nuk janë miratuar, prandaj aktualisht nuk ka ndryshim në kuadrin ligjor në fuqi.

Objektiva specifike 4.2 - Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale

Në funksion të zbatimit të masës **4.2.1 Fuqizimi i kapaciteteve për planifikim dhe zhvillim të politikave**- Janë realizuar 7 sesione të trajnimeve për zhvillimin e sistemit të performances komunale. Zyrtarët përfitues kanë qenë koordinatorët si dhe zyrtarët raportues në komuna. Gjithashtu gjatë muajit qershor është realizuar punëtorja “Zhvillimi i kapaciteteve të zyrtarëve të MAPL-së, për Zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK-së) si dhe Grantit të Performancës.

Masa 4.2.2. Ngritja e kapaciteteve profesionale brenda komunave për hartimin e dokumenteve strategjike- Është organizuar punëtorja në bashkëpunim me OSBE-në me zyrtarët komunal, me qëllim të harmonizimit të strategjive komunale me objektivat e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030.

4.2.3. Krijimi i kornizës standarde për monitorimin e zbatueshmërisë së dokumenteve strategjike dhe ndikimit të tyre - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

4.2.4. Përfshirja e hisedarëve në hartimin e dokumenteve strategjike që nga fillimi i procesit - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

4.2.5. Krijimi i mundësisë që të rishikohen Planet Zhvillimore Komunale (psh. përmes votimit me shumicë të kualifikuar) - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

4.2.6. Finalizimi i hartave zonale komunale- Gjatë periudhës raportuese, nga gjithsej 38 komuna: 20 janë të mbuluara me Plan Zhvillimor Komunal (PZHK), ndërsa komunat tjera janë në proces të hartimit të këtij Plani. Katër komuna kanë draftuar PZHK me mbështetjen e UN-Habitatit. Sa i përket Hartës Zonale Komunale (HZK): 11 komuna janë të mbuluara, 21 janë në proces të hartimit, ndërsa 6 nuk e kanë filluar ende këtë proces.

4.2.7. Harmonizimi i strategjive komunale me strategjitë nacionale - Gjendja e strategjive komunale për Zhvillim Ekonomik Lokal të harmonizuara me Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal është : 7 komuna kanë hartuar strategjinë për zhvillim ekonomik lokal: Prizreni, Klina, Lipjani, Skenderaji, Drenasi, Ferizaji, Kamenica; 8 komuna janë në proces të hartimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal: Deçani, Suhareka, Fushë Kosova, Gjiçani, Graçanica, Kaçaniku, Juniku, Rahoveci; 2 komuna të cilat kanë strategji valide por nuk e kanë të harmonizuar me PNZHEL janë: Shtime dhe Hani i Elezit; 20 komuna nuk kanë strategji për zhvillim ekonomik lokal: Dragashi, Mamusha, Peja, Istogu, Novobërda, Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku, Leposaviqi, Gjakova, Prishtina, Mitrovica Jugore, Vushtrria, Malisheva, Obiliqi, Klllokoti, Ranillugu, Shtërpca, Parteshi, Podujeva.

Objektiva specifike 4.3 - Përmirësimi i shërbimit dhe përgjegjshmërisë komunale

Masa 4.3.1 Digjitalizimi i shërbimeve komunale dhe shfaqja e tyre për aplikim në E-Kosova- Trajnimi i zyrtarëve komunal për implementimin e Platformës E-Komuna – Faza II është realizuar me mbështetjen e OSBE-së, ku qëllimi ishte përdorimi i avancuar i platformës E-Komuna, përmirësimi i shërbimeve digjitale, rritja e efikasitetit administrativ dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore për qytetarët.

4.3.2. Ofrimi i mbështetjes për komuna që ta bëjnë vendosjen e tarifave konform kostove të shërbimeve - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

4.3.3. Qartësimi i kompetencave në fushën e inspektimeve komunale - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

Objektiva specifike 4.4 - Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal

4.4.1. Identifikimi i fushave të përbashkëta me potencial zhvillimor në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal- Është realizuar një trajnim i përkrahur nga IKAP-i, i cili kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave për realizimin e projekteve të përbashkëta, duke theksuar rëndësinë e shkëmbimit të përvojave, optimizimit të burimeve dhe adresimit të përbashkët të sfidave lokale. Gjithashtu gjatë vitit 2025 janë realizuar takime koordinuese me komuna partnere me qëllim identifikimin e partnerëve potencial për bashkëpunim në fusha të ndryshme si: arsimit, kultura, bujqësia, mjedisi, turizmi etj. Paralelisht, është thelluar dhe zhvilluar komunikimi ndërinstitucional me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me komunat partnere jashtë vendit.

4.4.2. Stimulimi i krijimit të shoqatave lokale për përfaqësim të sektorit privat dhe krijimi i mekanizmave për bashkëpunim sistematik me shoqatat e krijuara - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

4.4.3. Krijimi i politikave stimuluese për anëtarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane - Për zbatimin e kësaj mase duhet të ndërmerren veprime konkrete në proces të hartimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe zbatimit të tyre. Deri më tani 7 komuna kanë hartuar Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në harmoni me PNZHEL.

4.4.4. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar - Gjatë kësaj periudhe janë iniciuar një numër i konsideruar i Nismave dhe Marrëveshje të reja binjakëzimi, si dhe është punuar në konkretizimin dhe rifreskimin e marrëveshjeve ekzistuese. Si rezultat, janë krijuar mundësi konkrete për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në kuadër të binjakëzimeve ndërkombëtare. Për realizimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal/marrëveshjeve të nënshkruara janë ndërmarrë veprimet si në vijim: 10 nisma\iniciativa të komunave për bashkëpunim ndërkomunal; 4 Marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal; 13 vendime të ligjshmërisë së nismave dhe marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkomunal; 10 nisma\iniciativa të komunave për bashkëpunim

komunal ndërkombëtar; 6 Marrëveshje të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar; 16 vendime të ligjshmërisë së nismave dhe marrëveshjeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar.

4.4.5. Krijimi i mekanizmit të veçantë për koordinimin e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal - Në këtë periudhë raportuese nuk ka aktivitet, por meqenëse PNZHEL ka afat të zbatimit deri në vitin 2030, kjo masë pritet të zbatohet brenda afatit të planifikuar në program.

IV. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Identifikimi i sfidave në vijim është i domosdoshëm për të adresuar progresin dhe për të përmirësuar zbatimin e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030:

1. Një nga sfidat kryesore ka qenë mos hartimi apo mos harmonizimi i strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal me PNZHEL 2030. Deri më tani harmonizimin me këtë dokument e kanë bërë 7 komuna: Prizreni, Klina, Lipjani, Skenderaj, Drenasi, Ferizaj, Kamenica; 8 komuna janë në proces të hartimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal: Deçani, Suhareka, Fushë Kosova, Gjilani, Graçanica, Kaçaniku, Juniku, Rahoveci; 2 komuna të cilat kanë strategji valide por nuk e kanë të harmonizuar me PNZHEL janë: Shtime dhe Hani i Elezit; 20 komuna nuk kanë strategji për zhvillim ekonomik lokal: Dragashi, Mamusha, Peja, Istogu, Novobërda, Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku, Leposaviqi, Gjakova, Prishtina, Mitrovica Jugore, Vushtrria, Malisheva, Obiliqi, Kllokoti, Ranillugu, Shtërpca, Parteshi, Podujeva.
2. Përveç kësaj, një tjetër sfidë është mungesa e raportimit dhe angazhimit e disa ministrive në zbatimin e strategjisë. Kjo ka bërë që të ketë mungesë koordinimi në nivel të Ministrive, duke penguar përpjekjet për të arritur qëllimet e përcaktuara në PNZHEL.
3. Me qëllim të mbështetjes së komunave në proces të harmonizimit të strategjive komunale për zhvillim ekonomik lokal me PNZHEL, MAPL ka planifikuar një takim të përbashkët me komunat me qëllim të diskutimit për obligimet e dala nga PNZHEL dhe takime individuale me komunat të cilat kanë nevojë për mbështetje profesionale.